



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.749/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes, Shqiprim Selimi nga Subjekti Politik Lëvizja për Bashkim, dega në Komunën e Shtimes, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.749/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes Shqiprim Selimi nga Subjekti Politik Lëvizja për Bashkim, dega në Komunën e Shtimes, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 03.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Shtimes Shqiprim Selimi nga Subjekti Politik Lëvizja për Bashkim, dega në Komunën e Shtimes, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2201X/04R, ku kanë votuar familjarët e tij (nëna, vëllai, axha dhe djali i axhës) i figurojnë si në FRP e po ashtu edhe në rezultatet përfundimtare vetëm një votë. Apelit i ka bashkangjitur si dëshmi letërnjoftimet e familjarëve të cilët pretendon se konfirmojnë që e kanë votuar derisa votat e tyre mungojnë. Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i kutisë VV 2201X/04R.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se votuesi anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Shtimes Shqiprim Selimi nga Subjekti Politik Lëvizja për Bashkim, dega në Komunën e Shtimes, brenda afatit ligjor ka parashtruar apel me të cilin ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin VV 2201X/04R në Komunën e Shtimes.

Paneli, me rastin e vendosjes së apelit ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga apeluesi dhe pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i parashtruesit të apelit se në vendvotimin me numër VV 2201X/04R i njëjti posedon më shumë se 1 (një) votë.

Në fletëvotimet që janë rinumëruar del se kandidati Shqiprim Selimi nga Subjekti Politik Lëvizja për Bashkim, ka fituar 1 votë në vendvotimin me numër VV 2201X/04R të cilat janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK dhe se të njëjtat vota iu janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK.

Andaj, Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.749/2021 më datën 07.11.2021**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.